



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA CËRRIK

Statistikat vendore (Date 09/01/2019)

• **Kompetencat**

Sektori i Statistikave është përgjegjës për:

- Identifikimin e mundësive për krijimin e një klime të favorshme për biznesin e vogël e mesëm.
- Analizimin e informacioneve ekonomike lidhur me planifikimin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve mbështetëse për biznesin.
- Raportimin për situatën ekonomike ,sociale, kulturore në sektorët përgjegjëse, brenda dhe jashtë bashkisë.
- Krijimin dhe mbajtjen e kontakte të vazhdueshme me zyrat analoge pranë institucioneve të tjera (INSTAT, Ministri) ,organizma të huaj e subjekte privat etj.
- Grumbullimin e informacionit nga Njësitë Administrative për efekte statistikore dhe informimi.
- Grumbullimin në mënyrë periodike (3,6,9,12) mujore të të dhënave nga drejtoritë e Bashkisë për efekt informimi.
- Studimin e tregut të punës dhe mundësitë për punësim të banorëve të Bashkisë.
- Krijimin dhe ofrimin e instrumentave me karakter informues(broshura,portale,manuale).

• **Struktura përgjegjëse**

Sektori i Statistikave ushtron kompetencat e mësipërme në varësi të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Pronave Publike dhe Financës. Ky sektor mbulohet nga dy punonjës:

-Përgjegjësi i Sektorit

-Specialisti

• **Statistika të përgjithshme (Date 06/02/2019)**

Bashkia Cërrik me planin e ri territorial të miratuar më 31 korrik 2014 nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në

Republikën e Shqipërisë”, mbulon 5 njësi (**Cërrik, Gostimë, Mollas, Klos, Shalës**) me një sip. totale **189.65 km²**.

(Date 29/05/2019)

Sipas të dhënave të Gjendjes Civile, Bashkia Cërrik ka 48.411 banorë, nga të cilët 14.880 individë banojnë në ***njësinë administrative Cërrik dhe*** 33.531 individë banojnë në ***njësitë e tjera administrative. 60% e popullsisë është e përqëndruar në njësitë administrative Cërrik dhe Gostimë.***




Tabela 1. Paraqitja grafike sipas shpërndarjes së popullësisë

Njësi administrative	Cërrik	Gostimë	Klos	Mollas	Shalës	Totali
Nr. Banorëve	14.880	13.860	4.482	7.928	7.261	48.411
Nr. familje	5026	3796	1336	2354	2050	14.562

Tabela 2. Numri i popullësisë dhe banorëve sipas njësive

(Date 15/08/2019)

NJ.A	Cërrik	Gostimë	Klos	Shalës	Mollas	Totali
Lindje	76	192	30	88	105	491
Vdekje	76	68	22	31	32	229

Tabela 3.Numri i lindjeve/vdekjeve sipas njësive respektive

(Date 09/09/2019)

Nga numri total i cipërcituar 49,6% e popullsisë janë meshkuj dhe 50,4% janë femra.



(Date 03/10/2019)

Sipas grup moshave, 21% e popullsisë i përkasin grup moshës 0-14 vjeç; 68% e popullsisë janë të grupmoshës 15-64 vjeç; 11% e popullsisë i përkasin grup moshës mbi 65 vjeç.

